



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 05 dhjetor 2018, në mbledhjen e gjashtë (6) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.05

Në mungesë të Kryetarit të komunës, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Bekim Bislimi, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Agim Blakçori, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, z. Faik Muçiqi, përfaqësues i emergjencave civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe znj. Donjetë Sheqiri, përfaqësuese e OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa mungoi: z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it dhe z. Skender Shatri – OSBE.

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, përshëndetje të gjithëve, Pasi që Kryetari është i zënë në një takim, ne do të fillojmë me mbledhjen e KKS-së. Materialet konsideroj se i keni marrë të gjithë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rendi i Ditës

U miratua njëzëri.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 29 tetor 2018

U miratua njëzëri

2. Raporte të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it për gjendjen e sigurisë në Komunë

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, fillimisht fjalën e ka Komandanti i Stacionit Policor z. Bekim Bislimi.

z. Bekim Bislimi, theksoi, konsiderojmë se gjendja e sigurisë në Komunë vlerësohet e qetë dhe stabile. Realisht kemi pasur një trend të ngritjes së veprave të ndryshme penale duke veçuar ato të vjedhjeve dhe vjedhjeve të rënda, por kanë qenë të raportitura edhe disa vepra të grabitjeve. Në këtë drejtim është shënuar rezultat sa i përket identifikimit dhe arrestimit të personave të dyshuar për përfshirje në këto vepra penale, janë identifikuar

dhe arrestuar gjashtë persona, janë kontrolluar dhe bastisur disa lokacione, me ç'rat gjetur dhe konfiskuar sende të cilat më parë kanë qenë të raportuara të vjedhuara dhe u janë kthyer pronarëve të ligjshëm.

Në kuadër të parandalimit, zbulimit të kryerësve të veprave penale, kemi arrestuar dy persona për posedim të substancave narkotike, ka mbetur në flagrancë tentativa për vjedhje të bagëtisë ku gjashtë krerë të bagatisë janë ndaluar dhe kthyer pronarëve, po ashtu janë konfiskuar edhe dy automjete të cilat janë shfrytëzuar nga të dyshuarit në këto vepra, gjatë procedurës së verifikimit ka rezultuar se edhe dy automjetet kanë qenë të raportuara të vjedhura.

Sa i përket gjendjes në komunikacion kjo periudhë ka shënuar rënie të aksidenteve në përgjithësi, plani për lirim të trotuareve, parkingjeve të parregullta etj. konsideroj se ka pasur sukses, të cilin e kemi ndërprerë përkohësisht për shkak të angazhimeve të shumta në çështje tjera operative por edhe të punimeve që janë duke u kryer në qytet.

Jemi në prag të përfundimit të vitit dhe sigurisht se do të kemi prezencë më të madhe të qytetarëve në hapsirat publike, kjo për shkak edhe të fluksit të mërgimtarëve, në këtë kontekst kemi planifikuar masa shtesë të sigurisë.

Përfaqësuesi i KFOR-it, theksoi, ju njoftoj se nga data 28 nëntor detyrën e ka marrë komandanti i ri i KFOR-it me gradë gjeneral, që i përket KFOR-it italian. Ai dhe të gjithë ne jemi të përkushtuar për mbajtjen e gjendjes së sigurisë të qetë dhe lirinë e lëvizjes në tërë territorin e Kosovës. Sa i përket punës tonë si ekip monitorues në Komunën e Podujevës ajo vazhdon e njëjtë pa ndonjë ndryshim të mandatit. Kemi bashkëpunim të mirë me institucionet komunale për gjendjen e sigurisë në Komunë. Sipas vlerësimeve tona situata e sigurisë në komunë është e qetë, stabile, nuk ka kërcënime për destabilizim. Kemi një bashkëpunim me Stacionin e Policisë këtu në Podujevë, ne e qmojmë punën e tyre dhe kemi konstatuar se bëjnë një punë të mirë sa i përket gjendjes së sigurisë.

z. Naim Bajraktari, bazuar në referencat tona përkatëse dhe kompetenete dhe misionin e FSK-së konstatojmë se gjendja e tanishme e sigurisë në Komunën e Podujevës është e qetë dhe stabile. E tërë kjo është rezultat i bashkëpunimit dhe bashkëveprimit të tërë mekanizmave, në radhë të parë i Policisë, KFOR-it, FSK-së dhe mekanizmave komunal. Edhe pse e kemi një situatë të qetë rikonfirmoj se FSK është e gatshme në çdo kohë dhe moment të përgjigjet në çfarëdo shtate eventuale në tërë territorin e Republikës së Kosovës, e në këtë rast në Komunën tonë. Njësitë tona të specializuara janë në gatishmëri maksimale me mjete dhe pajisje të duhura personale 24 orë për 365 ditë. Edhe pse jo formalisht, pasi që kjo i takon zyrës për informim të FSK edhe pak ditë na ndajnë deri te formimi i Forcave të Armatosura të Kosovës, gjegjësisht është një lajm që i gëzohen të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, sepse çdo njëri i ka kontribuar kësaj dite. Sa i përket projekteve infrastrukturore, Njësitet tona xheniere me 4 pjestarë dhe 3 automjete të rënda janë duke punuar në nivelizimin e oborrit të shkollës fillore “Naum Veqilharxhi” në fshatin Llapashticë, projekti ka filluar me 3 dhjetor dhe sipas planifikimit parashihet të përfundojë brenda 5 ditëve.

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, unë ju falënderoj për raportet dhe informatat e paraqitura. Gjithashtu dua të theksoj se me padurim e presim transformimin e Forcës së Sigurisë në Forcë të Armatosur sepse kjo do të ndikoj në sigurimin e një jete të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Kalojmë në pikën e radhës.

3. Informatë për gjendjen e pyjeve

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, fillimisht fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural z. Vezir Januzi.

z. Vezir Januzi, theksoi, nga 633 km³ sa ka territor Komuna e Podujevës, pyje janë 26.962 ha prej të cilave 11.852 ha i takojnë pronës private dhe 15.110 ha janë pronë shtetërore. E tërë sipërfaqja e mbuluar me pyje është e ndarë në tri (3) Njësi Menaxhuese: Turuqicë, Murgullë-Bellasicë dhe Popovë-Llapashticë, të cilat ndahen në Rajone Ekonomiko-Pyjore. Drejtori foli për rajonet ekonomiko-pyjore si dhe për numrin e stafit në kuadër të këtij sektori.

Nënvizoi, që nga data 13.07.2010 kompetencat në mbrojtjen e pyjeve kanë kaluar në Komunë konkretisht në DBPZHR kurse punët profesionalo-teknike i kryejnë zyrtarët nga Drejtoria Koordinuese Rajonale e APK-së në Prishtinë.

Për çdo vit nga APK-ja hartohen Draft Planet Menaxhuese të cilat na prezentohen dhe pas plotësimeve dhe propozimeve të mundshme nga ana jonë dhe shoqëria civile ato kthehen në APK nga të cilët pastaj hartohet Plani Menaxhues për vitin kalendarik.

Me këtë Plan parashihen të gjitha veprimet dhe masat që duhen ndërmarrë gjatë vitit kalendarik qoftë nga stafi i tyre apo nga stafi ynë, qoftë në pyje shtetërore, qoftë në pyje private

Gjatë vitit kalendarik me rregulla është e paraparë që çdo teren të kontrollohet, të regjistrohet së paku një herë e në raste të veçanta sipas nevojës edhe më shumë, deri më tani janë kryer regjistrime në njëmbëdhjetë (11) terene.

Këtë vit, në pranverën e hershme nga 11.03.2018 deri më tani kemi patur 51 raste të shfaqjes së zjarreve me intensitet të ulët, të mesëm dhe të lartë që kanë përfshi një sipërfaqe prej 82 ha prej të cilave 52 ha pyje private dhe 30 ha pyje shtetërore.

Gjatë sezonit veror kur paraqiten zjarre pyjore APK-ja për çdo vit angazhon puntorë sezonal të cilët intervenojnë në rastet kur paraqiten zjarre pyjore, kurse kohën tjetër angazhohen në pastrime dhe rrallime parakomerciale.

Tani me fillimin e sezonit vjeshtor kur mundësia e shfaqjes së zjarreve është më e vogël këtyre punëtorëve u është shkëputur kontrata e punës.

Me kërkesa të Njësisë hetimore nga Stacioni policor Podujevë kemi dalë në tetë (8) raste për vlerësime të dëmeve pyjore në prona private si pasojë e vjedhjes së masës drunore nga persona të huaj.

Nga rojet e pyjeve për dëme pyjore ndaj prerësve ilegal dhe për transport ilegal të masës drunore janë ngritur 213 fletparaqitje prej të cilave 35 penale dhe 178 kundërvajtëse.

Nga APK-ja këtë vit janë pyllëzuar 16 ha me pishë në vendet e quajtura „Brezovan,, dhe „Golesh,, , tetë(8) prej tyre ripyllëzime-plotësime të vitit të kaluar.

Hallkë të rëndësishme në mbrojtjen e pyjeve paraqet edhe bashkëpunimi me organet e rendit , Inspektoratin pyjor ,gjykatat dhe shoqërinë civile me të cilët mbahen kontakte të vazhdueshme dhe korrekte.

Këtë vit nga pronarët e pyjeve private janë parashtruar 356 Kërkesa për prerje pylli , deri më tani nga zyrtarët e APK-së janë shqyrtuar 223 kërkesa kurse taksa për shërbime në pyje private është paguar për 212 prej tyre dmth.janë lëshuar 212 leje për prerje pylli, vlera e taksës së paguar për shërbime në pyje private deri më dt.30.11.2018 është 34634.74 €, mjete këto që janë derdhur në llogarin e MBPZHR.

Si rezultat i kontrollave të zhvilluara nga stafi i sektorit, Inspektorati pyjor dhe Policia kufitare nga fillimi i vitit e deri më tani janë konfiskuar 468.73 m³.

Duke marrë parasysh numrin e fletëparaqitjeve dhe konfiskimit të masës drunore situata duket se është më e mirë, megjithatë kërkoj nga të gjitha institucionet relevante për mbrojtjen e pyjeve por edhe nga shoqëria civile, që të bashkëpunojnë dhe veprojnë në mënyrë që këto projekte të implementohen në mënyrë të kontrolluar sepse mendoj se pyjet duhet prerë derisa shteti nuk gjen ndonjë burim alternativ për ngrohje, ngase secili

qytetar ka nevojë për dru për ngrohje, por ne jemi duke punuar me përkushtim që këto pyje të prehen në mënyrë të kontrolluar.

z. Nexhmi Rudari Nënkrjetar i Komunës, unë e hap debatin, a ka dikush për të shtuar diçka.

z. Bekim Bislimi, theksoi, është reale se gjendja është më e mirë në raport se si ka qenë. U potencua çështja e pyllëzimit. Ne jemi në dijeni për dëmtimin e pyjeve dhe rëndësinë që kanë pyjet. Shtrohet pyetja se çka duhet bërë në të ardhmen. Mendoj duhet shqyrtuar mundësitë me të rinjtë, me punë vullnetare nga ana e të rinjve por edhe nga ne, në mënyrë që të bëhet pyllëzimi, këtë e kemi obligim.

z. Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, theksoi, Drejtori është më në rrjedha, por sa jam në dijeni në nivel vendi ekziston një plan për pyllëzim dhe ripyllëzim sepse më shumë kemi të bëjmë me ripyllëzim sesa me pyllëzime të reja. Ne si Komunë vazhdimisht kemi kërkuar por edhe kemi shprehë gatishmërinë tonë qoftë si Administratë komunale qoftë edhe në bashkëpunim me organizata të ndryshme si OJQ, shoqëri civile, organizata rinore etj, kurdo herë që Agjencioni ka në plan pyllëzimin e një hapësire të caktuar në territorin e Komunës sonë, nëpërmes Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, jemi të gatshëm të marrim pjesë në çfarëdo mënyre që të ndihmojmë në këtë drejtim. Dua të potencojë se si nxënës i shkollës së mesme kam marrë pjesë në aksione të organizuara për pyllëzim dhe ripyllëzim dhe ndihem mirë në këtë aspekt. Edhe ne si Komunë mund të kemi një plan të pyllëzimit dhe ripyllëzimit në parcela të vogla. Ne kemi në plan mbjelljen e drunjtëve dekorativ në hapësirat publike, por këtu është fjala për hapësira të pyjeve të dëmtura, të degraduara dhe ato janë me rëndësi të ripyllëzohen. Gjendja nuk është e mirë në nivel të Kosovës as në nivel të Komunës së Podujevës, është një degradim i jashtëzakonshëm, prerje e pyllit pa kriter, pastaj sikurse u potencua edhe në takimet tjera për mbulimin e gjurmëve bëjnë djegjen e pyjeve. Përveç kësaj pyjet duhet t'i mbrojmë edhe nga ndotja edhe nga mbeturinat, kemi vërejtur se në pyjet tona hedhen mbeturina, pra janë faktorë të shumtë që duhet përmirësuar. Besoj se DBPZHR ka plan operativ, ka kapacitete që t'i mbroj dhe avancoj pyjet në nivel të përgjegjësive të Komunës.

z. Vezir Januzi, në informatën e paraqitur potencova se me planin menaxhues merret Agjencioni Pyjor i Kosovës-APK, mirpo është mirë që APK dhe DBPZHR duhet ta mendojnë se duhet bërë paraprakisht një analizë e tokës, sepse ne pothuajse ka dhjetë vite që jemi duke pyllëzuar të njëjtat sipërfaqe mirëpo nuk po rezulton me sukses, nuk po ka efekt, d.m.th. fillimisht të bëhet një analizë dhe pastaj të bëhet pyllëzimi me llojin e drurit adekuat që i përshtatet. Jam në rrjedha se në projekt ligjin për pyjet është punuar shumë, është i gatshëm për procedim dhe miratim, ku janë të definuara kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve. Institucionet përkatëse thuajse po u ikin përgjegjësive. Komunat kanë vetëm mbrojtjen e pyjeve. Është e pamundur që me këtë staf të deleguar dhe në pamundësi për të rritur numrin, pastaj një roje e pyllit me koeficient të pagës 4.8, pa kushte, pa vetura, pa kompensim të rrezikshmërisë mendoj se është pak e rëndë, kështu që mendoj se së shpejti ky projekt ligj të miratohet dhe kompetencat të koncentrohen në një institucion, sepse shpërndarja e kompetencave dhe përgjegjësive ka bërë të pamundur edhe mbrojtjen e pyjeve. Pyjet janë pasuri kombëtare dhe duhet të interesohemi të gjithë, jo vetëm institucionet por edhe shoqëria civile. Ne si Drejtori jemi në bashkëpunim me të gjithë faktorët relevant, bashkëpunimi ka qenë shumë i mirë me Policinë, përfshirë edhe Policinë kufitare, ku një prej problemeve është depërtimi i masës drunore ilegale nga ana e kufirit me Serbinë dhe besoj se ky bashkëpunim do të vazhdojë.

z.Nexhmi Rudari,Nënkryetar i Komunës, theksoi, sa i përket ngrohjes, në këtë situatë kemi një avantazhë dhe disavantazhë. Si avantazh do të përmendja se një numër më i madh i qytetarëve kanë filluar të përdorin peletin si lëndë djegëse për ngrohje, e që ndikon për ruajtjen e masës drunore, por disavantazh është vendimi i Qeverisë të cilin e kemi mirëpritur për ndalimin e përdorimit të thëngjillit, sepse në këtë aspekt kërkesat për dru për ngrohje do të rriten dhe me vet faktin se pyjet tona janë shkatërruar në një masë shumë të madhe atëherë do të kemi vështëresi në ruajtjen dhe mbrojtjen e pyjeve, sepse kërkesat reale të qytetarëve për ngrohje janë këto. Nëse nuk keni diçka për të shtuar kalojmë në pikën e radhës.

4. Informatë për rastet e kthimit dhe integritit të qytetarëve në shtëpitë(pronat) e tyre

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, ky është një proces i cili ka filluar në vitin 2015, për shkak të ikjes masive të qytetarëve në shtetet perëndimore, që ndodhi në vitin 2014 ku veç se janë paraqitur vështëresitë e para me të kthyerit, në bashkëpunim me MPMS. Kryesisht komuna është orientuar në riatdhesimin e qytetarëve që vijnë nga Komuna e Podujevës, në strehimin e tyre, ndihma të ndryshme, qoftë në pako familjare, dru për ngrohje, trajtime shëndetësore, futjen në skemat sociale të atyre që i plotësojnë kushtet etj. vërtetë ka qenë një barrë dhe vazhdon të mbetet për komunat sepse komunat nuk kanë buxhet të paraparë për këtë. Lidhur me këtë fjalën ia jap z. Liman Zeqirit të na paraqet informatën.

z. Liman Zeqiri, theksoi, si Zyrë Komunale për Komunitete dhe Kthim jemi marrë me të kthyerit, ky është një proces që merremi me vite të tëra. Është fjala për personat të cilët dojnë të kthehen në vendin e origjinës dhe pronat e veta dhe në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiave ligjore duke koordinuar me Qendrën jemi angazhuar që së paku ata njerëz t'i gëzojnë të drejtat e tyre në Komunën tonë. Në vazhdim foli për përbërjen, aktivitetet dhe fushëveprimin e Komisionit Komunal për Riintegrim, si dhe për procesin e shqyrtimit të kërkesave dhe ndihmat e ofruara, trajtimin mjekësor etj.

Nënvizoi, gjatë vitit 2018 në Komunën tonë janë riatdhesuar rreth 183 persona, ku 60% prej tyre janë familje ndërsa 40% janë individ të kthyer pa familje, prej tyre 35 janë nxënës të shkollave fillore dhe të mesme. Nxënësit janë integruar në procesin edukativo-arsimor ku kanë qenë. Familjet të cilat kanë pasur nevojë për ndihmë emergjente prej tyre 10 familje kanë përfituar strehim të përkohshëm, 5 familje-trajtim mjekësor dhe medikamente, 6 familje-pako dimërore dru zjarri, 3 familje me orëndi shtëpiake dhe 3 familje kanë hyrë në skemë sociale. Pjesa tjetër e personave të riatdhesuar janë referuar të kërkojnë ndihmë në organizatat e huaja e sidomos ato gjermane siç janë: IOM, URA, AWO NURNBERG etj. shumica e këtyre personave janë orientuar veçanërisht në projektin për vetëpunësim, themelim biznesi projekt i cili financohet nga MPB dhe MPMS dhe menaxhohet nga UNDP me mjete pune në vlerë 3000 €. Fillimisht të gjithë këta persona lajmërohen në Zyrën për Integritet Evropian si të riatdhesuar, të dhënat e tyre futen në programin elektronik të riatdhesimit SMR, pastaj u lëshohet një konfirmim se personi është i riatdhesuar dhe drejtohen në Entin për Punësim, më pastaj Enti i referon rastet në Qendrën e Aftësimit Profesional-QAP në Prishtinë për të ndjekur trajnime në fusha të caktuara. Ata pajisen me certifikata të aftësimit dhe si rezultat hapin edhe bizneset e tyre. Monitorimet e bizneseve i bën Zyra për Integritet Evropian dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

z.Nexhmi Rudari,Nënkryetar i Komunës, e hap debatin rreth kësaj teme. Nëse nuk keni diçka rreth kësaj teme kalojmë në pikën e radhës.

5. Informatë nga DSHPM SH, DPUMM për projektet që ndikojnë në sigurinë e qytetarëve (p.sh. ndriçimi publik, zgjerimi i shtratit të lumenjve, ndërtimi i urave, shenjëzimet në rrugë, etj.)

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, unë konsideroj se të gjitha projektet në infrastrukturë në një formë apo tjetrën ndërlidhen me sigurinë e qytetarëve, mirëpo janë disa projekte më specifike që drejtëpërdrejtë ndikojnë në sigurinë e qytetarëve. Më hollësisht rreth kësaj teme do të flasë z. Faik Muçiqi.

z. Faik Muçiqi, dua të flas për projektet në mënyrë që ju të jeni në rrjedha, të cilat edhe janë të miratuara në Kuvendin e Komunës. Ndër projektet që i referohen çështjes së sigurisë publike kemi ndriçimin publik. Theksoi, këtë vit kemi përfunduar segmentin e fshatit Orllan, ku do të vazhdojmë edhe vitin e ardhshëm me një pjesë të rrugës kryesore, në fshatin Kërpimëh është duke u punuar dhe për herë të parë jashtë qytetit kemi filluar me ndriçime publike duke parë rëndësinë e këtij projekti edhe në çështjen e sigurisë, sepse siç e shihni për fat të keq ka vjedhje, grabitje dhe probleme të shumta. Në qytet është bërë ndriçimi në gjatësi prej 17 km që është në përfundim, tani është parku ku do të ndriqohet, duke ju mundësuar dhe lehtësuar shëtitjen një numri të madh të qytetarëve, pastaj do të vazhdohet edhe me periferi. Një pjesë e madhe e ndriçimit publik është duke u ndërruar me ndriçim më eficient dhe më i mirë. Në magjistrale kemi vazhduar ndriçimin deri te shkolla e fshatit Shtedim dhe jemi në përfundim e sipër, e që vitin e ardhshëm do të vazhdojmë deri në pikën kufitare, kjo do të ndihmojë në qarkullim sepse me ardhjen e bashkëatdhetarëve kjo rrugë është shumë e ngarkuar. Drejtori foli edhe për projektin e rregullimit të mureve mbrojtëse në segmentin e fshatit Lupç, si dhe për punët dhe fazat e realizimit të projekteve të zgjerimit të shtretërve të lumenjve në segmentet tjera, si dhe për planifikimet. Nënvizoi, hapjet e para të zgjerimit të lumenjve me muret mbrojtëse jemi duke i bërë këtë vit dhe do të vazhdohet nga viti i ardhshëm posaqërisht në lumin Llap, afër shkollave dhe venbanimeve ku ndjeshmëria është më e madhe. Një pjesë e madhe e urave janë përfunduar dhe janë duke u punuar, ndërsa sa i përket trotuareve këtë vit është një investim bukur i madh, rreth 10 km janë në fazën e përfundimit. Drejtori foli për lokacionet ku janë të përfunduara dhe që janë në proces të realizimit urat dhe trotuaret. Te shenjëzimi horizontal dhe vertikal janë investuar afër 26,000 €, janë përmirësuar bukur shumë rrugët e qytetit që në këtë rast falënderojmë policinë e cila ka kontribuar shumë për evidentimin e vendeve ku duhet vendosur shenjat. Te shenjat vertikale është e njëjta dukuri ku fatkeqësisht dëmtohen dhe vidhen. Po ashtu në disa rrugë janë vendosur pasqyrat. Këtë vit po ashtu është bërë riparimi dhe asfaltimi i disa rrugëve në qytet.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, e hapi debatin për këtë pikë, nëse ka dikush diçka për të shtuar apo pyetur.

z. Bekim Bislimi, unë do të shtroja çështjen e vendosjes së kamerave në qytet, projekt i cili ndikon drejtëpërdrejt në aspektin e sigurisë. Ky projekt është përkrahur nga KKSB dhe është premtim edhe i Kryetarit të Komunës, mirëpo shihet se ka ngecur.

z. Faik Muçiqi, theksoi, projekti për vendosjen e kamerave të sigurisë në qytet është proceduar në prokurim dhe sigurisht se këtë vit do të fillojë implementimi me një shumë më të vogël, ndërsa pjesa më e madhe e investimit do të kryhet me buxhetin e vitit 2019. Sa i përket vonësive kjo ka ndodhur për shkak se ka kaluar një kohë bukur e gjatë deri në përgatitjen e projektit.

Nuhi Selimi, sa i përket projekteve që ndikojnë në situatën e sigurisë publike unë e kam potencuar edhe më parë por po e përsërisë, është shumë e nevojshme ndërtimi i trotuareve te ura në fshatin Orllan, për shkak të rrezikshmërisë së lartë të qarkullimit për

nxënësit e shkollës por edhe për kalimtarët tjerë. Pastaj çështje tjetër shumë shqetësuese është nevoja për vendosjen e barrierave në rrugën përgjatë Liqenit të Batllavësnë vendin e ashtuqujtur “Bërryli i Xhakalivë” për arsye se ka aksidentime të veturave. Pra është e nevojshme që në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës të veprohet lidhur me këtë, të bëhet një zgjidhje, sepse nuk është distancë e madhe, janë rreth 30-40 m.

z. Qefser Behrami, lidhur me temën rreth projekteve për çështje të sigurisë unë kam dy vërejtje: në SHFMU Pakashticë nuk funksionon fusha sportive dhe nxënësit nuk kanë hapësirë për të zhvilluar aktivitete. Kjo rezulton si kërkesë nga prindërit edhe pse unë kam paraqitur kërkesën në DKA. Vërejtja tjetër ka të bëjë me mullirin e ujit në fshatin Pollatë. Ai mulli gjatë kohës së luftës ka qenë 24 orë në shërbim të popullatës dhe aty është një urë në gjendje jo të mirë dhe paraqet rrezikshmëri për kalimtarët. Pra kërkesa është se a ekziston mundësia për rregullimin e urës. Është edhe një çështje të cilën ka dy herë që e kam potencuar, në rrugën magjistrale që vjen nga Mitrovica që lidhet me fshatin Revuçë ajo është me një rrezikshmëri shumë të madhe për nxënësit e shkollës, sepse automjetet i vozisin me shpejtësi shumë të madhe, është e nevojshme vendosja e ndonjë pengese në rrugë.

z. Faik Muçiqi, lidhur me vërejtjen e parafolësit dua të theksoj se ndërtimi i urës te Mulliri dhe në lagjen Ademaj është çështje e planifikuar dhe do të filloj ndërtimi.

z. Liman Zeqiri, theksoi, është mire dhe inkurajuese kur ka kërkesa të qytetarëve për investime në projekte të natyrës së sigurisë publike. Unë e ndëgjova Drejtoin shumë me vëmendje dhe e përgëzoj për punët e kryera. Singërisht dua ta theksoj se me infrastrukturë Komuna jonë qëndron shumë mire. Në qoftë se i referohemi edhe ndarjes së buxhetit nga Niveli qendror unë mbetem i habitur me tërë këtë punë voluminoze, për ndërtimet infrastrukturore të kryera në përgjithësi. Pra duke marrë përbazë lartësinë e buxhetit, unë e përgëzoj Drejtorin për punën që ka bërë dhe t’i japim mbështetje për angazhimet dhe punën e tij në projekte dhe menaxhimin e bërë, kjo është realiteti.

z. Agim Blakçori, desha të ndërlihem te projekti për fushat e sportit. Këtë vit në kuadër të projekteve investive të Drejtorisë së Arsimit janë ndërtuar katër(4) fusha të edukates fizike, dhe së shpejti do të hyjnë në prioritet dhe do të realizohen edhe fushat tjera për të gjitha shkollat.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, para se t’ia jap fjalën Kryetarit të Këshillit të Bashkësisë Islame, unë desha ta përgëzoj për vendimin e miratuar në Kuvendin e Komunës që Komuna merr përsipër mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Podujevës të besimit islam.

z. Osman Kurtolli, po ndërlihem me projektet që ndikojnë në sigurinë publike. Kam një kërkesë për në fshatin Shajkoc. Pasi që është një fshat me numër të madh të banorëve dhe rruga është shumë e ngarkuar me qarkullim të madh të automjeteve dhe vozitjes së shpejt, për shkak se nxënësit e shkollës por edhe banorët tjerë i ekspozohen rrezikut në çdo moment, kërkesa është për vendosjen e pengesave në rrugë.

Ndërsa sa i përket Vendimit të miratuar nga Kuvendi për heqjen e shpenzimeve të varrimit për banorët e Komunës, besoj se ky është interes i të gjithëve dhe ne e mirëpresim dhe i falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë çështje.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, nëse nuk keni diçka tjetër kalojmë në pikën e radhës.

6.-Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit të punës për vitin 2019

-Formimi i Grupit punues për përgatitjen e Informatës për punën e KKSBB për vitin 2018

-Formimi i Grupit për hartimin e Planit Operativ lokal (2019-2020), sipas

Strategjisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015-2020

z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, për nënpikat; -Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit të punës për vitin 2019 dhe -Formimi i Grupit punues për përgatitjen e Informatës për punën e KKSB për vitin 2018, propozoj që përbërja e grupeve të jetë e njëta sikurse që ka qenë për vitin 2018, me përjashtim që në vend të të ndjerit Shaban Ahmeti të caktohet një anëtar tjetër. Grupet për mbledhjen e radhës të përgatitin draftet e dokumenteve për shqyrtim.

Konstatim:

Nënkyetari pas aprovimit të propozimit që Enver Rama të caktohet në përbërje të grupit në vend të të ndjerit Shaban Ahmetit, konfirmoi ngritjen e Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së KKSB-së për vitin 2019, në përbërje:

- 1.Faik Muçiqi
- 2.Bekim Bislimi
- 3.Agim Blakçori
- 4.Naim Bajraktari
- 5.Enver Rama
- 6.Donjetë Sheqiri

Ndërsa për përgatitjen e Informatës për aktivitetet e KKSB-së në vitin 2018, pas aprovimit, konfirmoi ngritjen e Grupit punues, në përbërje:

- 1.Faik Muçiqi
- 2.Bekim Bislimi
- 3.Liman Zeqiri
- 4.Rizah Muqolli

-Formimi i Grupit për hartimin e Planit Operativ lokal (2019-2020), sipas Strategjisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015-2020

Konstatim;

Nënkyetari pas aprovimit të propozimeve konfirmoi ngritjen e Grupit punues për hartimin e Planit Operativ lokal (2019-2020), sipas Strategjisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015-2020, në përbërje:

1. Bekim Bislimi
2. Bekim Jashari
3. Agim Blakçori
4. Zaim Thaçi
5. Donjetë Sheqiri
6. Naim Bajraktari

7. Të ndryshme

z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, pasi që nuk keni diçka në këtë pikë më lejoni të përmbyll mbledhjen duke ju falënderuar për pjesëmarrje dhe kontribut, si dhe duke konstatuar se me gjithë ngritjen e numrit të veprave penale dhe kundërvajtjeve në

këtë periudhë konsiderojmë se gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Podujevës është e qetë, në kontrollë të plotë, për çka edhe e falënderoj Policinë Kosovës por edhe mekanizmat tjerë që kanë ndikim në ruajtjen e gjendjes së qetë dhe të sigurt, por në veçanti do të falënderoja të gjithë qytetarët e Komunës që me veprimet e tyre bëjnë që ne të kemi një mjedis të qetë. Edhe pse numri i veprave penale ka shënuar rritje në këtë muaj, po ashtu edhe kapja e keqëbërësve dhe inicimi i procedurave tjera gjyqësore është shtuar dmth. është për të falënderuar Policinë që kanë qenë jashtëzakonisht në nivel.

Mbledhja përfundoi në orën 11.30

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr. 02-060/01-0094099/18
Podujevë,
05 dhjetor 2018**

**Kryetari i Komunës
Agim Veliu**